



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ

Adresa:Fushe-Arrez,Prefektura Shkoder,Tel:027123131,Email:info@bashkiafushearrez.gov.al

Fushe-Arrez me, 28/03/2024

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS - “Blerje ushqime per Kopsht, Çerdhe, QKF”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

15542000-9 Djath i fresket

15811100-7 Buke

15131620-7 Mish i grire viçi

15300000-1 Fruta, perime dhe produkte te peraferta

VLERA E FONDIT LIMIT – 1 570 035 (nje milion e peseqind e shtatedhjete mije e tridhjte e pese) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 55, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve tenike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori Ekonomik te kete ne ekstraktin e QKR-se furnizime te ngjashme te realizuara.

Argumentimi: Kerkese e mesoperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, Ligji Nr.162, date 23.12.2020 “Perprokurimin publik”, nenit 40, pika 5 germa a, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e madhe se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, ne piken 2/c, neni 43, dhe pikën 4, neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

Vlera e xhiros se percaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik, për të pasur siguri që operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit te QKB.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe neni 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 germa d.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik dueht të vetëdeklarojë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 bazuar ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të garantojë transportin e të gjithë mallrave për në magazinën e Bashkisë duke ruajtur parametrat e cilësisë së tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit

2.3.3 Operatori Ekonomik të ketë në Ekstraktin e QKR-se furnizime të këtij lloji ose ekuivalente me të.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 , të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Plotesimi i ketj kriteri nga operatorët ekonomik deshmon per pervojen e subjektit per kryerjen e ketij sherbimi.

2.3.4 Cdo produkt i sjelle nga furnizuesi duhet te shoqerohet me flet analizen perkatese, kjo per te gjithë ato produkte qe e kane te domosdoshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 , të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Ky kriter kerkohet nga autoriteti kontraktor qe operatori ekonomik te kete flet analizat perkatese per te siguruar qe produkti i sjelle te jete i kontrolluar.

2.3.5 Furnizimi me artikujt ushqimor do te realizohet sipas kerkesave te perdoruesit, kjo me shume per ato artikuj qe ruajtja e tyre kerkon parametra me te veqante.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 , të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.